



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA Durrës
KËSHILLI BASHKIAK

PROÇESVERBAL

Nr. 17, datë 06.09.2022

I mbledhjes së Këshillit Bashkiak Durrës, që zhvillohet në sallën e Këshillit Bashkiak

Orari i fillimit të mbledhjes : 12:10

Data e mbajtjes së mbledhjes : 06.09.2022

Mbajtja e mbledhjes : Salla e Këshillit Bashkiak

Lloji i Mbledhjes: Mbledhje e Radhës

Përfaqësuesit e Bashkisë Durrës: Kryetarja e Bashkisë znj.Emiriana Sako dhe përfaqësues të drejtorive, që kanë përgatitur materialet për mbledhjen plenare.

Zamira Mustafaraj: Përshëndetje ! Të nderuar Këshilltarë! E nderuar Kryetare! Të nderuar të Pranishëm! Uroj të keni kaluar një sezon veror të gëzuar.

Atëherë deklaroj të hapur këtë mbledhje të radhës.

Në këtë mbledhje do të shqyrtojmë dhe miratojmë mbi projektvendime të propozuara nga kryetarja e bashkisë dhe 2 komisione të përhershëm të këshillit. Dokumentacioni ju është vënë në dispozicion në postën elektronike nga sekretarja e këshillit.

Ftoj sekretaren të bëj prezencën në sallë.

Dorina Milja: Përshëndetje! Fillojmë me prezencën.

Jolanda Mustafaraj ... prezent.....deri tek.... Morena Boja...prezent.

Janë 34 këshilltarë në sallë.

Zamira Mustafaraj: Faleminderit.

Meqë kuorumi është i pranishëm, vazhdojme me mbledhjen.

Po kaloj në leximin e pikave të rendit të ditës.

Pika 1. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E FAMILJEVE PËRFITUESE TË NDIHMËS EKONOMIKE NGA FONDI I KUSHTËZUAR PËR BLOK NDIHMËN EKONOMIKE DERI 6 % DHE FONDI NGA TË ARDHURAT E BASHKISË, PËR MUAJIN GUSHT 2022
Pika 2. shtese Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E PËRDORIMIT TË FONDIT TË RINDËRTIMIT TË PËRFITUAR NË ZBATIM TË VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR. 503, DATË 27.07.2022 “PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT, PËR FINANCIMIN E RINDËRTIMIT TË BANESAVE INDIVIDUALE NË BASHKITË DURRES, VORË DHE SHIJAK”
Pika 3.shtese Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN PËRDORIMIT TË FONDIT TË KUSHTËZUAR TË BUXHETIT TË SHTETIT PËR EMERGJENCAT CIVILE, QË I ËSHTË ALOKUAR BASHKISË DURRES PËR VITIN 2022 NË VLERËN 51’984’331,06 LEKË
Pika 4. shtese Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E PËRDORIMIT TË FONDIT PREJ 81’000’000 LEKË PËR LIKUJDIMIN E DETYRIMEVE NDAJ OSHEE
Pika 5.shtese Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit të 2 komisioneve të këshillit	PËR MIRATIMIN E NJË NDRYSHIMI NË ANEKSIN NR.1, TË VENDIMIT TË KËSHILLIT BASHKIAK NR. 22, DATË 25.02.2021 “PËR MIRATIMIN E LISTËS TË SUBJEKTEVE PËRFITUESE, QË DO TË PËRFITOJNË NGA PROGRAMI I PROCESIT TË RINDËRTIMIT PËR PALLATIN NR. 1062, RRUGA “26 NËNTORI” DHE PALLATIN NR. 14, RRUGA “PETRAQ BOSHNJAKU” NJËSIA ADMINISTRATIVE NR. 2, TË DËMTUARA NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019”

Ka ndonjë koment për pikat e rendit të ditës?

Kalojmë në votim nëse nuk ka.

Miratohet rendi i ditës me 34 vota pro.

- Kalojmë në projektvendimin e **pikës 1**, i japim fjalën Komisionit të Barazisë Gjinore dhe Mirëqënies Sociale znj.Klementina Meçi.

Klementina Meçi: Faleminderit! Përshëndetje të gjithëve!

Komisioni i Barazisë Gjinore dhe Mirëqënies Sociale mori në shqyrtim pikën e parë të rendit të ditës dhe vendosi me vota unanime miratimin e projektvendimit dhe kalimin për votim në mbledhjen e ditës së sotme sipas relacionit të dorëzuar nga bashkia. Faleminderit.

Zamira Mustafaraj : Faleminderit.

Komente ose pyetje përsa i përket pikës 1 të rendit të ditës, kemi? Atëherë kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 1 të rendit të ditës?

Kundra?....

Abstenim ?Nuk ka.

Atëherë miratohet me 34 vota pro.

- Kalojmë në shqyrtimin për **pikën 2**, i japim fjalën Komisionit të Buxhetit, Financës Taksave-Tarifave znj. Morena Boja.

Morena Boja : Përshëndetje.

Atëherë Komisioni i Buxhetit, miratoi pro kalimit të pikës 2 të rendit të ditës për votim në këshillin bashkiak. Faleminderit.

Zamira Mustafaraj : Faleminderit.

Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike znj. Etleva Budini.

Etleva Budini: Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike u mbledh me mjete të komunikimit online për të shqyrtuar projektvendimin dhe relacionin e vënë në dispozicion nga administrata e bashkisë Durrës në lidhje me pikën 2 të mbledhjes së ditës së sotme dhe vendosi unanimisht për: “Për miratimin e përdorimit të fondit të rindërtimit të përfituar në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 503, datë 27.07.2022 “Për përdorimin e fondit të rindërtimit, për financimin e rindërtimit të banesave individuale në bashkitë Durrës, Vorë dhe Shijak”. Faleminderit.

Zamira Mustafaraj : Faleminderit.

Komente ose pyetje për pikën 2? Atëherë kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 2 të rendit të ditës?

Kundra?....

Abstenim ?Nuk ka.

Miratohet me 34 vota pro pika 2 e rendit të ditës.

- Kalojmë në shqyrtimin për **pikën 3**, i japim fjalën Komisionit të Buxhetit, Financës Taksave-Tarifave znj. Morena Boja.

Morena Boja : Edhe përsa i përket pikës 3 të rendit të ditës, komisioni vendosi pro kalimit të saj për votim në mbledhjen e këshillit bashkiak. Faleminderit.

Zamira Mustafaraj : Faleminderit.

Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike znj. Etleva Budini.

Etleva Budini: Gjithashtu dhe komisioni ynë pasi shqyrtoi relacionin dhe projektvendimin e bashkisë me gjithë sqarimet e duhura vendosi unanimisht për: “Për miratimin përdorimit të fondit

të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për emergjencat civile, që i është alokuar bashkisë Durrës për vitin 2022 në vlerën 51'984'331 lekë". Faleminderit.

Zamira Mustafaraj : Faleminderit.

Komisioni i Mbrojtjes Civile, Sigurisë Publike, Emergjencave Civile dhe Shëndetësisë z. Afrim Bakaj

Afrim Bakaj : Komisioni i Emergjencave Civile ra me shumicë votash dakord që pika 3 të kaloj për miratim në këshillin bashkiak. Faleminderit.

Zamira Mustafaraj : Faleminderit.

Komente ose pyetje për pikën 3?

Atëherë kalojmë në votim.

Kush është pro pikës 3?

Kundra?....

Abstenim ?

Miratohet dhe pika 3 me 34 vota pro.

- Kalojmë në shqyrtimin për **pikën 4**, i japim fjalën Komisionit të Buxhetit, Financës Taksave-Tarifave znj. Morena Boja.

Morena Boja : Atëherë përse i përket pikës 4 të rendit të ditës "Për miratimin e përdorimit të fondit prej 81'000'000 lekë për likuidimin e detyrimeve ndaj OSHEE", Komisionit të Buxhetit, Financës Taksave-Tarifave Vendore vendosi pro kalimit të pikës 4 për votim në mbledhjen e këshillit bashkiak. Faleminderit.

Zamira Mustafaraj : Faleminderit.

Komisioni i Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës me kryetare znj. Etleva Velçani.

Etleva Velçani : Komisioni i Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës pasi mori në shqyrtim pikën 4 të rendit të ditës vendosi me shumicë votash kalimin në votim. Faleminderit.

Zamira Mustafaraj : Faleminderit.

Komente ose pyetje?

Morena Boja : Po , kisha unë.

Zamira Mustafaraj : Po.

Morena Boja : Atëherë nga relacioni që na është vënë në dispozicion thuhet se : "Menaxhimi i konsumit të energjisë të Bashkisë Durrës për ndriçimin publik është bërë për 189 kontrata ...". Cilët janë kontraktorët? Flitet për bashkinë Durrës dhe institucionet në varësi?

Dhe diçka tjetër këtu thuhet që, kontratat janë të mbifaturuara, pra kjo llogaritje prej 81 milion lekë ndaj OSHEE, është bashkë me mbifaturimet? Sepse me sa kuptoj kërkesa e bashkisë Durrës me ministrinë përkatëse është me datë 29.08.2022 dhe besoj se Ju nuk e keni një përgjigje apo rishikim të mbifaturimeve, të paktën në relacion nuk është përmendur.

Dhe diçka tjetër këtu thuhet që, një pjesë e shpenzimeve këtu shkon për ndriçimin dhe pyetja ime është : A ka bashkia Durrës një projekt për të financuar ndriçime me energji të rinovueshme apo metoda të tjera, pra për të mos patur një kosto kaq të lartë në buxhetin e saj karshi OSHEE-s? Faleminderit.

Mirela Stefani (specialiste e bashkisë) : Përshëndetje !

Jam inxhinjerja e bashkisë që merrem me menaxhimin e energjisë në bashkinë e Durrësit dhe 189 kontrata i takojnë komplet ndriçimit të qytetit dhe njërive administrative të Durrësit. Përsa i takon gjëndjes debitore, që është krijuar Ne jemi në një akt verifikimi që po bëjmë midis përfaqësuesve tanë dhe përfaqësuesve të OSHEE, nuk ka mbaruar akoma jemi në proces. Ka rezultuar që një pjesë e vlerës së debisë ekziston dhe një pjesë nuk ekziston, tani deri kur të mbaroj procesi i verifikimit. Por kjo vlerë Ne na duhet që të kalojmë procesin e emergjencës. Të paguajmë ato çfarë Ne kemi detyrime dhe mos të dalim më vlera debitore.

Morena Boja : Po nuk do ishte më korrekte verifikimi shifrës me përfaqësues të ministrisë, sepse këtu flitet për tërheqjen e fondeve nga investime të tjera.

Mirela Stefani : Po

Morena Boja : A ka parashikuar bashkia Durrës përshembull për shkollën “Met Hasa” investim tjetër ? Sepse këtu thuhet në relacion gjithmonë, se nuk është prokuruar akoma dhe për këtë arsye ky fond i kalon shlyerjes së detyrimeve ndaj ministrisë për shkak të emergjencës civile.

Unë mendoj se duke qënë se jam dhe e profilit, momenti që unë heq disa para, për tu bërë e kuptueshme për ato që na ngjojnë, patjetër që duhet të bëjmë një parashikim se si do zëvendësohen këto para, përshembull investimin e shkollës, se t’i heqësh nga shkolla dhe mos kesh asnjë plan riinvestim po në këtë institucion publik, mendoj që nuk është korrekte, kështu mendoj unë.

Mirela Stefani : Kjo pjesë që i përket emergjencës së fondeve për shlyerje detyrime është që e ka bashkia Durrësit si detyrim. Ne mund të kemi, por edhe mund të mos kemi më tepër, por ky 81 milion lekësh na duhet për momentin, që të kalojmë gjëndjen e bllokimit që na është bërë. Kështu që Ne duhet të likujdojmë këto që kemi dhe pjesa tjetër pastaj ngelet në verifikimin në vazhdim dhe deri këtu e kemi bërë verifikimin, nuk ka mbaruar komplet, por deri këtu është bërë. Një pjesë e këtyre kontratave është bërë .

Emiriana Sako : Valbona, kishe gjë ti ?

Valbona Qirjako (Drejtoresh e Buxhetit bashkia): Po, për shkollën “Met Hasa”. Përshëndetje !

Përsa i përket investimit në shkollën “Met Hasa” dhe në relacion Ne e kemi shprehur që ky investim nuk do të hiqet, por do të shtyhet afati i financimit, sepse procedura, sikur të filloj tani mbaron në fund të vitit, domethënë në dhjetor dhe kontrata i bie të lidhet ose në fund të dhjetorit ose në janar dhe kjo është në PBA, domethënë nuk është hequr si investim, por financimi do të kryhet në vitet 2023-2024 ose dhe brënda vitit 2023, pra nuk është hequr si investim vetëm shtyhet afati i financimit.

Morena Boja : Por pyetja ishte me cilat fonde do e financoni ? Apo do ta riprogramoni sërish ?

Valbona Qirjako : Po do e riprogramojmë në buxhetin e vitit 2023, në PBA 2023-2025.

Morena Boja : Dhe një pyetje tjetër. A ka bashkia përshëmbull, sepse Ne shpeshherë na dalin financime për emergjencat civile, siç ishin mbetjet, tani na doli OSHEE-ja apo plane të tjera të përfshira tek emergjencat civile .

A parashikoni Ju të përfshihni në buxhet një fond, që i shkon në mënyrë të drejtpërdrejtë emergjencave civile? Sepse mendoj që, kur hartohet buxheti disa para do duhen dhe për emergjencat civile.

Valbona Qirjako : Në buxhet janë parashikuar fonde për emergjencat civile. Për vitin 2022 fondi ka qënë nga ana e bashkisë 8 milion, ndërkohë kemi dhe një fond, që na vjen nga qeveria në formën e transfertës së pakushtëzuar për emergjencat civile dhe përdoret vetëm për këtë destinacion dhe për këtë vit fondi na erdhi 51 milion.

Si rregull ky fond duhet të vi 4 (katër) % e buxhetit të bashkisë, që varion apo duhet të jetë rreth 120 milion lekë. Këtë vit deri tani kanë ardhur 51 milion, të cilat Ne po i realokojmë. Pra gjithmonë kemi fonde për emergjencat civile.

Morena Boja : Ok, faleminderit.

Zamira Mustafaraj : Faleminderit.

Pyetje tjetër, koment? Kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të pikës 4?

Kundra?

Abstenim ?

Miratohet dhe pika 4 me 34 vota pro .

- Kalojmë në shqyrtimin e projektvendimit për **pikën 5**, i japim fjalën Komisionit Rregullores dhe Çështjeve Juridike me kryetare znj. Alneida Rroshi.

Alneida Rroshi : Faleminderit. Përshëndetje të gjithëve.

Komisioni Rregullores, Çështjeve Ligjore, pasi mori në shqyrtim praktikën për pikën 5 për ndryshimin e Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 22, datë 25.02.2021, propozon në mënyrë unanime për ta kaluar në votim. Faleminderit.

Zamira Mustafaraj: Faleminderit.

Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike znj. Etleva Budini.

Etleva Budini : Gjithashtu dhe Komisioni ynë vendosi unanimitisht për kalimin e kësaj pike për votim. Faleminderit.

Zamira Mustafaraj : Faleminderit.

Komente ose pyetje për pikën 5 të rendit të ditës ?

Morena Boja : Po, unë .

Zamira Mustafaraj : Po.

Morena Boja : Unë kisha një pyetje përsa i përket pikës 5 të rendit të ditës. Sepse personit në fjalë i është dhënë e drejta të përfitimit të një apartamenti 2+1, nga 1+1 që ka përfituar më parë nga procesi i rindërtimit. Pyetja ime është : A ndjek Zyra e Rindërtimit të njëjtën procedurë për të gjithë ? Sepse në djenin time unë kam ankesa nga qytetarë që mendoj se janë shumë më ligjore dhe më të ligjshme sesa se ky miratimi që Ne po kalojmë dhe qytetarit në fjalë nuk i njihen fëmijët minoren që ka në certifikatë familjare dhe nuk i aprovohet e drejta e ndërtimit të një banese 2+1 edhe pse ai e ka pasur 3+1, por kërkon të ndërtoj një banesë 2+1 dhe jo 1+1 siç është miratuar në këshill, duke qënë se ka pretendimin që përveç 2 prindërve në certifikatën familjare janë dhe 2 fëmijë minoren, që nuk kanë qënë të regjistruar në momentin e tërmetit, por shoh që e njëjta logjikë është logjika e pikës së rendit të ditës që Ne po kalojmë.

Atëherë pse bëhet ky diferencim tek disa jepet e drejta e përfitimit të një apartamenti sipas kërkesave që bën qytetari dhe disa të tjerëve nuk i jepet e drejta edhe pse ndërtimi do të bëhet në të njëjtin truall, pra pronën që ka individi përkatës. Mund të ma sqaroj pak Zyra e Rindërtimit, ose komisioni përkatës që ka trajtuar çështjen.

Emiriana Sako : Ky material në fakt është një material, i cili është një ankesë e një qytetari e trajtuar nga këshilli bashkiak, kështu që mundet grupet që e kanë shqyrtuar patjetër që duan të japin një argumentim. Për rastet që Ju përmendni, duhet që rast pas rasti të bëjmë miratime në këshillin bashkiak listave, familjeve, ankesave të qytetarëve dhe sigurisht dhe herës tjetër kam kërkuar që të flasim me ankesa konkrete dhe jo në përgjithësi sepse dhe keqinformojmë. Ne jemi në dispozicion të gjithë qytetarëve përsa i takon programit të rindërtimit qoftë me informimin, qoftë me shqyrtimin e ankesave të tyre. Është një proces dinamik pjesa më e madhe e punës është përfunduar të pakën si vlerësim, sepse ok objektet janë akoma në kantiere, por rast pas rasti Ne duhet që nëqoftëse kemi një ankesë konkrete të na drejtohet ankesa dhe rasti që Ju flisni në bazë të ankesës që ka qytetari në mënyrë që të japim një përgjigje. Për mos tu zgjatur se mbase dhe këshilli do të jap një përgjigje të tij, në përgjithësi nuk i diskutojmë dot në përgjithësi rastet.

Morena Boja : Jo nuk dua të them në përgjithësi, por në logjikën time në fakt shikoj që një qytetar ka bërë ankesë në janar dhe shikoj që një tjetër ka bërë ankesë në korrik nuk më duket normale

dhe nuk më duket e drejtë. Pastaj Zyra e Rindërtimit duhet t'i shqyrtojë ankesat rast pas rasti dhe nuk mund të shqyrtoj një ankesë, që është bërë së fundmi dhe mos të shqyrtoj një ankesë që është bërë që në janar dhe aq më tepër mendoj që ligjërisht është në rregull, pra si mund të mosllogarisësh fëmijët minoren ku do regjistrohen tjetër fëmijët përveçse me prindërit? Kjo është pyetja ime.

Etleva Budini : Më falni, a mund të ndërhy.

Zamira Mustafaraj : Po.

Etleva Budini : Përderisa jam kryetarja e Komisionit të Strehimit që e ka trajtuar këtë rast ankese duke përfituar dhe nga biseda që patëm më parë bashkë privatisht, kuptova që ankesa për të cilën Ju flisni i drejtohet Komisionit të Posaçëm, ndërsa kjo është një ankesë që i është drejtuar këshillit bashkiak dhe kryesisht komisioneve që merren me këtë punë. Kështu që, unë dhe si kryetare e komisionit, por edhe si anëtare e këshillit bashkiak kam qënë gjithmonë e vendosur që në të gjitha rastet kur kemi nxjerrë listat e përfituesve të paktën të gjithë familjarët, të gjithë aplikuesit që kanë aplikuar në programin shtëpia online të marrin të paktën aq sa kanë pasur dhe kam qënë kategorike për këtë.

Është një rast i tillë dhe e kemi trajtuar në këtë aspekt duke u bazuar sigurisht në VKM nr.904 që thotë për ndërtesat, që ndërtohen në të njëjtin truall duhet të përfitojnë të njëjtën hapësirë siç e kanë pasur. Kjo është mënyra si është trajtuar ky rast.

Rasti që Ju flisni Morena i është drejtuar Komisionit të Posaçëm dhe ai ka ngelur i patrajtuar, mund t'i drejtohet këshillit bashkiak dhe do ta marrim në trajtim.

Morena Boja : Nuk mendoj se bën diferencë drejtimi i ankesës nëse i është drejtuar Këshillit apo komisionit përkatës, mendoj që duhet të ketë një koordinim dhe këto raste nuk mund të lihen pa trajtuar se i drejtohen komisionit dhe këto raste që i drejtohen Këshillit mund të trajtohen.

Etleva Budini : I është drejtuar komisionit, në Këshill Bashkiak s'ka ardhur akoma.

Emiriana Sako : Morena t'i thua që ai ka marrë përgjigje negative nga bashkia, do të thotë që ai përgjigjen e ka marrë, pastaj i pëlqen përgjigja apo jo qytetarit është diskutim tjetër. Është një gjë të mos trajtohesh fare dhe një gjë të marrësh përgjigje negative. Ne zbatojmë legjisllacionin, aktet normative, që kanë dal për atë procedurë.

Nëqoftëse ke dhe njëherë po e përsëris një ankesë konkrete të bashkisë na e dorëzo ose në sekretari ose në zyrën time se gjithmonë komunikimet i kemi pasur të vazhdueshme, pastaj nëse përgjigja ka qënë nga ana e bashkisë negative për vendimin që ka qytetari, kjo është një gjë që nuk është momenti për ta diskutuar këtu.

Etleva Velçani : Kisha diçka. Nëse ka raste të tjera si kjo e jona që e kemi sot për miratim nuk është më mirë që Ne t'i lajmërojmë qytetarët se ndoshta jo të gjithë e dinë që duhet bërë një

ankimim pranë këshillit bashkiak. Nëse Ne do të kalojmë këtë i hapet rruga dhe të tjerëve nëse kanë të njëjtin rast.

Zamira Mustafaraj: Faleminderit.

Kalojmë në votim e pikës 5 dhe të fundit të rendit të ditës?

Kush është pro?

Kundra?

Abstenim ?

Miratohet dhe pika 5 me 31 vota pro dhe 3 vota kundër.

- **Ka kërkuar fjalën** znj. Etleva Velçani.

Etleva Velçani : Faleminderit.

Bëhet fjalë për pallatin nr.15, rruga “Abaz Çelkupa”. Këta banorë kanë bërë disa herë ankesa pranë bashkisë për vendimin e oponencës.

Dua të di: Çfarë procedurash janë ndjekur për zgjidhjen e kësaj çështje?

Dhe e dyta : Pse janë vonuar procedurat ligjore të kthimit të përgjigjeve, pse nuk janë zbatuar afatet ligjore?

Emiriana Sako : Subjekti Gora është një pallat që me ekspertizë të thelluar dhe oponencë të Institutit ka dal për shëmbje. Ne duke marrë në konsiderat ato ankesa apo nevoja për detajim që kanë pasur qytetarët apo banorët e atij pallati, jemi drejtuar dhe njëherë studios projektuese në mënyrë që të shikoj ankesat e qytetarëve dhe jemi në pritje të një përgjigje nga ana e tyre. Pra kjo, nuk është një gjë që ka lidhje me afatet, është një vendimmarrje teknike të cilët duhet parë nga inxhinjerët, thënë këtë në bazë të përgjigjes së tyre, që Ne besojmë që do të mbyllet brënda këtij muaji, duke qënë se ka qënë dhe muaji që relativisht njerëzit janë pushim. Nuk flas për institucionin e bashkisë së Durrësit, po flas për subjektin, i cili e ka dorëzuar njëherë projektin dhe në këtë rast po i kërkojmë që ta rishikoj. Më tej do të kaloj për oponencë në Institutin e Ndërtimit, që të marr dhe vlerësimin nga ata, sepse Instituti e ka marrë një vlerësim. Për të vazhduar me informimin e qytetarëve më tej.

Etleva Velçani : Faleminderit.

Është ideja pasi kjo gjë zgjati shumë. Nga koha kur oponenca ka dalë dhe banorët kanë bërë kërkesa, ka pothuaj 1 vit e gjys që banorët mbahen me shpresa hë sot, hë nesër, shpresojmë që të marrin një përgjigje konkrete.

Zamira Mustafaraj: Faleminderit.

- **Ka kërkuar fjalën** z. Valentino Mustaka.

Valentino Mustaka : Tashi unë kisha 3 pyetje.

Pyetja e parë është në lidhje me një shkresë që ka ardh pranë Këshillit Bashkiak në lidhje me emërtimin e rrugëve të qytetit Durrësit, sepse ka emra rrugësh që duhen ndryshuar. Nuk e di tashi

është ngrit ndonjë grup pune që të studioi këtë gjë, apo nuk është ngrit ? Nëqoftëse është ngrit çfarë rezultati ka dhënë grupi i punës që është ngrit për këtë punë? Pyetja e parë.

Pyetja e dytë: Neve si këshilltarë na vinë shumë email-e nga banorë të ndryshëm dhe me thënë të drejtën kanë problemet e tyre shqetësuese dhe një nga ato email-e që mua më ka bërë përshtypje shumë është për kanalin e ujërave të nalta të Spitalles. Në veçanti ka shumë ankesa nga banorët e asaj zone aty. Nuk e di është marrë takim me banorët atje kur është bërë studimi i këtij kanali apo nuk është marrë? Sepse një pjesë bëhet me tuba dhe një pjesë me kanal të hapur, që ka të bëjë me ndotjet që kalojnë aty para shtëpive të tyre, me miskonjat, me shumë gjëra e aspekte të tjera.

Dhe pyetja e tretë që kisha është në lidhje me pallatet që po rindërtohen. Mendoj se ka ardhur koha që një pjesë e këtyre pallateve që kanë përfunduar pjesërisht, mund të hyn banorët atje në mënyrë që mos t'i jepet lekë qiraje atyre, sepse rrin pallatet bosh të riparuar dhe banorët marrin lekët e qerasë. Unë konkretisht e kam me pallatin që kam përballë me shpinë, për pallatin e Çelës. Aty ka mundësi që të sistemohen njerëzit, mos marrin qera koti dhe pallatet rrin atje të përfunduara. Unë këto mendime kisha. Këtë të fundit e them dhe si specialist me përvojë në ndërtim. Këto kisha.

Emiriana Sako : Faleminderit për shqetësimet e përcjella.

Përsa i takon shkresës nuk kemi qasje për të ndryshuar emrat e rrugëve, sepse janë përcaktuar me një komision të posaçëm nga Prefektura dhe në Këshillin Bashkiak në vitin që është bërë miratimi i gjithë sistemit të adresave në qytetin e Durrësit.

Rast pas rasti atje ku një rrugë e caktuar nuk ka emër, numër, mund të ndryshojë me një emër, me një kontribut që ka dhënë për qytetin e Durrësit, do bëjmë vlerësimet në bazë të një komisioni dhe më tej kalon në Këshillin Bashkiak. Pra shqyrtim të emrave në përgjithësi nuk kemi bërë, se kemi marrë në konsiderat.

Valentino Mustaka : Sepse ka mundësi të rifreskohen ca emra.

Emiriana Sako : Mund të jetë e vërtetë kjo që thoni Ju. Por kjo sigurisht që bëhet me një iniciativë publike, e një grup interesi apo pse jo një pjesë e anëtarëve të këshillit dhe Ne do të japim vlerësimin tonë patjetër do të ngremë komisionin e posaçëm nga ana e bashkisë së Durrësit për të marrë vendimmarrjen përkatëse.

Sa i takon çështjes së dytë kanali i ujërave të larta që fillon nga lagjja 10 dhe shkon deri në Porto-Romano është bërë një punë e jashtëzakondshme, një punë e cila prej 30 vitesh nuk është vënë dorë në këtë zonë sa i takon banorëve, lagjjeve që prek dhe problematikave që mbart ky investim. Ne kemi parashikuar mbas një projekti të miratuar me oponencë teknike mbylljen e kanalit, i cili tashmë është realizuar nga lagjja 10, rruga “Hajdar Dushi” deri në Spitalle tek rruga “Syri Detit”, pra gjithë sipërfaqja, aktualisht është zbatuar duke kaluar dhe Varrezat e Vjetra , pastaj nga “Syri Detit” deri tek Varrezat e Reja kanali është i hapur dhe pas Varrezave të Reja do përpunohet vet me mirëmbajtje. Kjo është sa është hartuar nga ekspertët dhe grupi teknik duke i dhënë prioritet dhe infrastrukturës së ujërave të bardha.

Ky projekt do të shkoj paralelisht me një projekt tjetër të rëndësishëm që është përfunduar nga ana e Ujësjiellës -Kanalizimeve, ai i rrjetit të kanalizimit të ujërave të zeza në zonën e Spitalles

dhe zonën e Durrësit të ri apo ish-Kënetës, të cilat janë ato zona që realisht kanë densitetin më të madh të banorëve. “Ne” do të kërkojmë investime në qeveri për këtë projekt, që tashmë është realizuar. Mendoj që është bërë një punë e jashtëzakondshme aty dhe ka njëfarë impakti direkt në jetën e qytetarëve në atë zonë. Sipërfaqet e përfituara, deri para një muaji kanë qënë sipërfaqe të hapura, sot mbyllja e kanaleve sjell shtimin e sipërfaqeve publike në të cilin ne duam të bëjmë një projekt të mirfilltë për të qënë një hapsirë publike, pjesërisht e kalueshme nga makinat për përdorim. Nuk mund të garantojmë, pra projekti nuk është parashikuar që të jetë një rrugë kalimi për mjetet e rënda, por është mbyllja e një kanali të ujërave të larta dhe e gjithë kjo sipërfaqe do të jetë publike, në të cilën do të ndërmarrim një projekt shumë të rëndësishëm për t’i dhënë asaj zone një alternativë lëvizje për këmbësorët dhe biçikletat si dhe për të krijuar hapësira publike, hapësira për fusha sporti për fëmijët, pra tërësisht një gjë tjetër nga ajo që ishte para 6 muajsh. Problem i tretë që Ju ngritët është ai i përfundimit të pallateve. Ne atje ku mbarojmë objektet, pra ku bëjmë procesin e kolaudimit sigurisht që banorët i kthehen normalitetit si të thuash, kthehen në apartamentet e tyre dhe sigurisht që nuk paguhet bonusi i qerasë. Ne për bonusin e qerasë bëjmë një analizë të detajuar çdo muaj dhe për informacioni tuaj mund të them numrat e familjeve që vinë në ulje, në maj kemi paguar 3400 familje, në muajin qershor-korrik 3345, në muajin gusht 3227, gjithmonë duke rakorduar dhe me institucionet që zbatojnë punimet në bashkinë e Durrësit, sepse nuk është vetëm bashkia që ka rforcim objekte, por është Fondi Shqiptar i Zhvillimit, i cili me ndërtimin e apartamenteve dhe ndërtimin e banesave individuale është në një proces të vazhdueshëm.

Valentino Mustaka : Personalisht unë di që edhe Juve iu është dërguar një letër nga një person, madje ai i është drejtuar dhe Kryeministrit. Unë kam marrë takim me banorët atje, rreth 50 banorë, që janë të pakënaur për pjesën e kanalit të hapur flas.

Emiriana Sako : Dakord, unë e sqarova pak, se nuk dua që të përsëris veten. Puna që është bërë është një punë e jashtëzakondshme, që të themi të vërtetën. Sigurisht që banorët do të kenë pretendime për të vazhduar më tej dhe kjo është diçka shumë positive.

Ne po zbatojmë vetëm një fazë deri tani të projektit, projekti është një projekt i rëndësishëm që nuk kap vetëm kanalën e ujërave të larta Spitallë, por kap edhe ato të njësive administrative, në Arapaj, Shën Vlash e të tjera me radhë, të cilat në vitet që vinë do të kërkojmë investim. Do të kërkojmë mbështetje nga qeveria shqiptare për t’i realizuar dhe ato, qoftë mbylljen, qoftë betonimin e tyre. Gjithsesi unë e theksove me fillimin e punës për kanalën e ujërave të zeza në zonat, në këto 2 zona që përmendëm situata do të ndryshojë dhe me kanalën e hapur, sepse aty do të diferencojmë derdhjen e ujërave të zeza në kanalet e ujërave të larta.

Valentino Mustaka : Faleminderit.

Zamira Mustafaraj: Faleminderit.

- **Ka kërkuar fjalën** znj. Morena Boja.

Morena Boja : Në fakt unë kisha një sugjerim me pyetjen e 3-të që bëri Valentini dhe unë sugjeroj që pallatet, që janë të kolauduara dhe Ne i kemi përcaktuar familjet përfituese me Vendim të Këshillit Bashkiak nuk mendoj se duhet t'i lëmë akoma të presin, mendoj që duhet të akomodohen dhe në këto raste edhe ata akomodohen dhe bashkia kursen bonusin e qerasë. Ky është sygjërim, por e tha dhe Valentini paraprakisht. Faleminderit.

Zamira Mustafaraj : I japim fjalën Kryetares së bashkisë.

Emiriana Sako : Meqënëse jemi mes këshilltarëve dhe median prezent. Ne kësaj jave fillojmë një aksion të rëndësishëm për të takon lirim të hapësirave publike. Do të filloj puna me lirim e hapësirave publike në lagjen 17 dhe më tej do të filloj puna me lirim e hapësirave publike në lulishtet e Mauzeleumit të Dëshmorëve. Kemi bërë njoftimin zyrtar nëpërmjet IMTV-së dhe Policisë Bashkiake duke i lënë afat gjithë subjekteve që kanë zënë këto hapësira publike brënda kësaj jave duhet të lirojnë gjithë territoret e zëna që janë sheshe në mënyrë që Ne të fillojmë me investimin për rikthimin e këtyre hapësirave dhe rikthimin e lulishteve qytetarëve.

Ditën e premte është afati i fundit dhe për këto subjekte do të jenë në terren IMTV-ja dhe Policia Bashkiake në mënyrë që të kemi mundësi të fillojmë këtë aksion. Është shumë i rëndësishëm, është një aksion i kërkuar shpeshherë nga ana e qytetarëve të Durrësit, i cili do të shtrihet dhe në zonat e tjera. Do të shtrihet dhe në shëtitoren e plazhit, ku së shpejti do të fillojmë investimin aty dhe më tej dhe në rrugët kryesore të qytetit të Durrësit që janë të zëna nga lokalet dhe baret me tenda e struktura, të cilat nuk lejojnë aksesin e lirshëm të qytetarëve.

Unë Ju falenderoj dhe Ju uroj dhe një sezon të mbarë.

Zamira Mustafaraj: Faleminderit.

Duke Ju falenderuar për pjesmarrjen, mbledhjen e deklaroj të mbyllur.

Ky procesverbal mbyllet me nr. rendor 12 (dymbëdhjetë) faqe, i cili pasi verifikohet firmoset nga Komisioni i Verifikimit të Procesverbalit, sipas Rregullores Këshillit dhe Procesverbalit të Kryesisë dhe 2 Kryetarëve të Grupeve Politike në Këshill së datës 09.06.2022.

Mbajtësi i procesverbalit: Dorina Milja

Komisioni i Verifikimit të Procesverbalit :

Kryetar i Këshillit Bashkiak :

ANI DYRMISHI (mungon)

Zëvendëskryetare e Këshillit (drejtuese e mbledhjes) :

ZAMIRA MUSTAFARAJ

Sekretare e Këshillit Bashkiak :

DORINA MILJA

Kryetar i Grupit të Partisë Socialiste të KB :

AFRIM BAKAJ

Kryetar i Grupit të Pavarur të KB :

ETLEVA VELÇANI